



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
AGJENCIA SHETETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
DŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES



Nr: 07/2026

Datë: 28.01.2026

Duke marrë parasysh nenin 12, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), në pajtim të nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit si dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 3) të Ligjit Nr. 08/L-111 për Arkivat (Gazeta Zyrtare Nr. 30/5 shtator 2022), U.D. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, z. Bekim Aliu, më 28/01/2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet përditësimi i Planit të Integritetit 2024–2026 të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, përkatësisht për vitin 2026.
2. Zbatimi i Planit të Integritetit për vitin 2026 si në pikën një (1) monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga zyrtari përgjegjës për monitorim, në bashkërendim me strukturat përkatëse brenda institucionit.
3. Monitorimi dhe vlerësimi bëhen edhe në përputhje me kërkesat dhe mbikëqyrjen metodologjike të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Përditësimi i Planit të Integritetit për vitin 2026 është ndërmarrë pas vlerësimit të zbatimit të Planit të Integritetit 2024–2026 në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Nga ky vlerësim është konstatuar se pjesa më e madhe e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar me progres të kënaqshëm, ndërsa disa masa mbeten ende në proces zbatimi dhe kërkojnë rishikim, qartësim dhe përshtatje sipas gjendjes aktuale.

Gjithashtu, gjatë periudhës së zbatimit janë evidentuar ndryshime në rrethanat institucionale, përfshirë ndryshime në strukturën organizative dhe në udhëheqjen e institucionit, të cilat ndikojnë në rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm. Në këtë kontekst, janë marrë parasysh edhe rekomandimet dhe udhëzimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), me qëllim që masat parandaluese të jenë të zbatueshme, të matshme dhe në harmoni me kërkesat metodologjike.

Përditësimi është bërë në përputhje me Metodologjinë për Hartimin dhe Zbatimin e Planit të Integritetit dhe synon forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe uljen e rreziqeve të korrupsionit në proceset dhe funksionet kryesore të institucionit.

Bazuar në sa më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Personit përgjegjës për monitorim të Planit të Integritetit;
- Arkivit të ASHAK;
- Drejtorëve të Departamenteve të ASHAK;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHETETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES



PËRDITËSIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT (2024 – 2026)

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës

29/01/2026

Përditësimi i Planit i Integritetit								
Fushat e përgjithshme të rrezikut								
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut			Masat ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Menaxhimi financiar	Planifikimi i buxhetit në mënyrë jo adekuate.	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	7	21	Trajnime për zyrtarët përgjegjës për buxhet dhe shpenzimet buxhetore	- ZKA - ZKF - Burimet Njerëzore	2026
	Inventarizimi dhe regjistrimi jo efikas i pasurive		5	5	25	Regjistrimi dhe inventarizimi i çdo asti dhe materialeve shpenzuese në sistemin E - pasuri	- ZKA - ZKF - DMSHP	2026
	Mungesa e zyrtarit për e-pasuri.		8	9	80	Angazhimi i një zyrtarit për e-pasuri me detyrë shtesë.	- ZKA - Burimet Njerëzore	2026
	Planifikimi jo i mirë i Planit të Prokurimit.	Ligjet dhe aktet nënligjore	4	6	24	Të realizohet një analizë e detajuar e planeve të punës së departamenteve, me qëllim të identifikimit të saktë dhe të bazuar të nevojave reale për	- ZKA - ZKF - ZPP	2026



Menaxhimi i prokurimeve publike					realizimin e detyrave, para hartimit të Planit të Prokurimit, në mënyrë që të sigurohet planifikim i saktë dhe i realizueshëm.		
	Hartimi dhe realizimi i Planit të Prokurimit	6	8	48	Hartimi i Planit të Prokurimit duke pasqyruar në mënyrë reale kërkesat dhe nevojat e autoritetit kontraktues. Zbatimi i afateve të procedimit sipas legjislacionit. Publikimi i raporteve periodike/vjetore të realizimit të Planit të Prokurimit.	- ZKA Zyrtari i Prokurimit DPSHP	2026
	Menaxhimi i projekteve/kontratave	7	7	49	Hartimi i planit të brendshëm për caktimin e menaxherëve të kontratave mbi bazën e planit të prokurimit për vitin përkatës; Trajnimi paraprak i personave që planifikohet me qenë menaxher i kontratave për të rritur	- ZKA Burime Njerëzore Burime Njerëzore	2026



						përgjegjshmërinë në zbatimin e ligjit. Mbikëqyrje e vazhdueshme e menaxherëve të kontratave mbi zbatueshmërinë.	Menaxherat e kontratave	
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	Mosplotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të pamjaftueshëm	Aktet ligjore dhe nënligjore	8	10	80	Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit	- ZKA - Burimet Njerëzore	2026
	Profesionalizmi i pamjaftueshëm i zyrtarëve					Analiza e nevojave të trajnimeve. Trajnim i vazhdueshëm i stafit.	- Burimet Njerëzore	2026
Cenimi i integritetit të AShAK	Mungesa e Kodit Etik në AShAK	Aktet ligjore dhe nënligjore	6	6	36	Hartimi i Kodit etik në AShAK; Shpërndarja e Kodit Etik të gjithë zyrtarët e AShAK dhe organizimi i takimeve për informim të përmbajtës së Kodit	ZKA Burime Njerëzore	2026

	Nivel i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit dhe informimit të zyrtarëve për raportim ndaj korrupsionit.					Trajnim dhe informim i vazhdueshëm i stafit.		
Fushat e veçanta të rrezikut								
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut			Masat ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Rregullimi dhe përpunimi i dokumenteve arkivore	Sasia e lartë e materialit arkivor e parregulluar, krahasur me numrin e të punësuarve në këto njësi	Aktet ligjore dhe nënligjore	7	7	49	Të përgatitet Plani i punës për zyrtarët e rregullimit të materialit arkivor, konformë normave të punës, duke zbatuar Udhëzuesin metodik për rregullimin e materialit arkivor.	- ZKA - DAQ - DKMAN	2026
	Mungesa e zyrtarëve në rregullim dhe përpunim të		8	10	80	Shtimi i numrit të të punësuarve në njësitë e rregullimit të materialit arkivor.	- ZKA - Burimet Njerëzore	Vazhdimësi

	materialit arkivor.							
	Mungesa e trajnimeve profesionale stafit.					Trajnimi i stafit profesional në fushën e arkivisikës.	- ZKA - Burimet Njerëzore	2026
Menaxhimi me dokumente arkivore	Mungesa e evidencave të detajuara të materialeve arkivore në AQ dhe ANK.	Aktet ligjore dhe nënligjore të AShAK	8	8	64	Vendosja e të dhënave në SEMMA.	- ZKA - DAQ - DKMAN	2026
	Mos respektimi i Rregullores 06/2024, për kushtet, kriteret dhe procedurat e shfrytëzimit të materialit arkivor		5	6	30	Zbatimi dhe mbikëqyrja rigoroze e Rregullores për shfrytëzim të materialit arkivor nga zyrtarët përgjegjës për shfrytëzim.	- Udhëheqësit drejtpërdrejt të zyrtarëve obligohen për zbatimin e Rregullores.	2026
	Mos respektimi i afateve ligjore dhe procedure së parapare për trajtimin e kërkesave		3	2	6	Zbatimi i Rregullores për shfrytëzimin e materialit arkivor. Kontrolli dhe mbikëqyrja e njësive përgjegjëse për trajtimin e kërkesave	- DAQ - ANK - DPSHP	2026



Inspektimet	Mungesa e planifikimit për inspektime arkivore në nivelin qendror dhe lokal.	Ligji për Inspektime dhe Rregullorja aktete tjera ligjore dhe nënligjore	8	8	64	Të hartohet Plani i inspektimeve në bazë të Rregullores 07/24 për Kushtet, Kriteret dhe Normat e Detyrueshme të punës, për mbrojtjen dhe përdorimin adekuat të materialit arkivore, neni 4, paragrafi 2 dhe 3, si dhe Ligjit Nr. 08/L-067 për inspektime.	- DI - DPSHP	2026
						Kontrolli dhe verifikimi i zbatueshmërisë së planit të inspektimeve.		
						Publikimi i planit të inspektimeve në baza periodike në Ueb faqe te ASHAK		

